



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

29 mars 2024

DEKLARATË

Në mbështetje të nenit 7, pika 1, të Rregullores së Kuvendit, shpreh përkrahjen ndaj standardeve të transparencës dhe angazhimit qytetar, të bashkëhartuara nga Kuvendi, shoqëria civile dhe media.

Bashkëhartimi i standardeve është bazuar në metodologjinë e zhvilluar nga Partneriteti për Qeverisje të Hapur (OGP) dhe Deklarata për Parlament të Hapur, e mbështetur nga organizatat e shoqërisë civile në Konferencën Globale për *E-Parliament*-et në vitin 2013.

Procesi u bazua edhe në indikatorët për parlamente demokratike, të konceptuar nga Unioni Ndërparlamentar (IPU) në përputhje me objektivat 16.6 dhe 16.7 të Kombeve të Bashkuara për zhvillim të qëndrueshëm.

Ky proces i mirëstrukturuar midis Kuvendit, shoqërisë civile dhe medias, i mbështetur nga Sekretariati për Transparencën dhe Teknologjinë e Informacionit, tregon vullnetin për të promovuar transparencën, aksesin, pjesëmarrjen dhe llogaridhënien, parime themelore të parashikuara në legjislacionin shqiptar, përfshirë Rregulloren e Kuvendit dhe Planin Strategjik të Kuvendit.

Zhvillimi i këtyre standardeve i hap rrugë bashkëhartimit të Planit për Parlament të Hapur. Deputetët, stafi parlamentar, shoqëria civile, gazetarët, akademikët dhe grupe të tjera interesi do të punojnë së bashku për të vendosur në këtë plan angazhimet që do të ndërmarrë Kuvendi për të arritur dhe ruajtur standardet e dakordësuara në këtë dokument.

Përmes këtij angazhimi ne promovojmë transparencën parlamentare dhe qasjen në informacion duke kontribuar kështu në një demokraci më gjithëpërfshirëse.

KRYETARE
LINDITA NIKOLLA

